

CURRICULUM VITAE

Emri dhe Mbiemri: Aurela Velo
Kombësia: Shqiptare
Vendlindja: Lushnje
Datëlindja: 18.07.1972
Adresa e banimit: Rruga "Isuf Elezi", Ndërtesa 7, Shkalla 8, Hyrja 7, Tiranë
Numri i Kontaktit: cel. +355 682047162
Adresa e-mail: aurela.velo@financa.gov.a

KUALIFIKIMI ARSIMOR

1. Emri i institucionit dhe adresa	Universiteti Bujqësor i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë
Datat e ndjekjes së studimeve	1990-1994
Diploma e fituar	Bachelor dhe Master Shkencor në Ekonomi Agrare (diplomuar me rezultate maksimale me notë mesatare 9.9)
2. Emri i institucionit dhe adresa	Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë
Datat e ndjekjes së studimeve	2001-2002
Diploma e fituar	Çertifikuar si Ekspert Financë-Bankë (Menaxhim bankar, menaxhim projektsh, kontabilitet bankar, finance)
3. Emri i institucionit dhe adresa	Instituti i Certifikuar në Kontabilitet Financiar Publik (CIPFA), Mbretëria e Bashkuar, në kuadër të Projektit të bashkëpunimit për përsosjen e financave publike ndërmjet Ministrisë së Financave të Shqipërisë dhe Qendrës së Exelencës në Finance (CEF), Slloveni.
Datat e ndjekjes së studimeve	2005-2007
Diploma e fituar	Diplomë Ndërkombëtare në Kontabilitet Financiar Publik (Menaxhim financiar, menaxhim projektsh, kontabilitet menaxhimi, financë publike, audit, informatikë ekonomike, politika fiskale)
NIVELI I NJOHJES SË GJUHËVE TË HUAJA (vleresimi nga 5 – 1 (5 = shumë mirë, 4 = mirë, 3 = mjaftueshëm etj.)	Anglisht- 5 Italisht- 5

TRAJNIME TË AVANCUARA

-Qershor 2006, Tetor 2007, Qershor 2009 trajnuar në “Cash&Debt Management” organizuar nga CEF-Slloveni.
-2011-2012 Çertifikuar nga kompania Oracle si Trajnere Funksionale e Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë financuar nga fondet IPA (projekti për zgjerimin e Sistemit të Thesarit).
-Shtator 2017 dhe Dhjetor 2018 trajnuar “Raportimi Financiar Publik” organizuar nga CEF-Slloveni.
-Qershor 2019 Çertifikuar “Grater than Ridership”, Banka Botërore, Seoul- Kore e Jugut.
-Maj- Gusht 2021 Çertifikuar nga ACCA në “Public Financial Management”
-Janar- Prill 2022 Çertifikuar nga ACCA në “Accrual IPSAS”
-2021-2022 Çertifikuar nga CIPFA si “Trajnere për Standartet Ndërkombëtare në Kontabilitetit Publik me baza rritëse (Accrual IPSAS)” (projekt financuar nga qeveria Zviceriane dhe Banka Botërore).

Përmbledhje Profesionale

Eksperienca prej 27 vite punë në financat publike më ka ndihmuar shumë për të krijuar një njohuri shumë të mirë mbi këtë sektor, konkretisht: procesin e planifikimit dhe zbatimit të buxhetit, sistemin e thesarit të shtetit, rolin dhe funksionalitetet e tij, menaxhimin e shpenzimeve dhe të ardhurave buxhetore, procesin e zbatimit të kontabilitetit publik dhe raportimit financiar në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, procesin e kontrollit të brendshëm financiar publik, metodologjitë dhe instrumentet e menaxhimit të likuiditeteve të Qeverisë dhe parashikimit financiar, strukturën dhe skemën e fondeve speciale, menaxhimin e fondeve të financimit të huaj në Shqipëri nga kreditorë dhe donatorë të ndryshëm, konsolidimin financiar dhe raportet financiare të Qeverisë, të gjitha politikatat dhe baza ligjore mbi të cilat është ndërtuar dhe zhvilluar sektori publik në Shqipëri ndër vite.

Si Drejtor i Procesimit të Biznesit prej më shumë se 13 vitesh dhe aktualisht Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit, jam e specializuar në të gjitha proceset e buxhetimit dhe zbatimit të tij, ndërtimin dhe raportimin e pasqyrave financiare, rregullat e kontrollit të brendshëm financiar dhe vlerësimin dhe menaxhimin e rrishtit, politikatat dhe strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale të Qeverisë. Jam eksperte dhe zotëroj njohuri shumë të mira të strukturës funksionale të Sistemit të Informatik Financiar Shqiptar për ekzekutimin e buxhetit, kontabilitetit dhe raportimin financiar të Qeverisë.

Kam një përvojë dhe njohuri shumë të mirë në menaxhimin dhe zbatimin e projekteve, analizat financiare dhe përkthimin teknik të rregullave financiare dhe të kontabilitetit në gjuhën e sistemeve të informacionit. Kam ushtruar rolin e Projekt Menaxherit dhe homologut kryesor funksional për Ministrinë e Financave në dy projekte shumë të mëdha dhe të rëndësishme: Projekti për zgjerimin e Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ) dhe Projektin për ndërtimin dhe zbatimin e Sistemit Informatik Menaxherial Financiar (SIMF), si dhe integrimin e tyre me sistemet e tjera të Administratës Publike dhe sistemit bankar (rol menaxherial në përgatitjen e termave funksional të

referencës, përgatitjen e manualeve të përdorimit të sistemeve, trajnimin e stafeve, testimet funksionale të proceseve të punës në sisteme), me objektiv të përgjithshëm forcimin e menaxhimit të financave publike në Shqipëri në përputhje me Partneritetin Evropian dhe Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim.

Gjithashtu prej vitit 2019 jam anëtare e Grupit të Menaxhimit të Projektit për zbatimin e Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit Publik me baza rritëse (Accrual IPSAS), ku në bashkëpunim me kompaninë zbatuese të projektit, jam angazhuar në përgatitjen e analizës së mangësive procedurale dhe ligjore në kontabilitetin publik me baza të konstatuara në Shqipëri, dokumentimin e nevojave për zhvillimin funksional të Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë në përputhje me këto standarte, përgatitjen e manualeve të punës për standartet kontabile të përzgjedhura dhe, si trajnere e Accrual IPSAS çertifikuar nga CIPFA, kam trajnuar stafin e punonjësve të financës të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme të përzgjedhur për trajnim në të gjithë Shqipërinë.

Aftësitë

E vendosur për të tejkaluar vazhdimisht pritjet. E vullnetshme për të marrë përsipër përgjegjësi të shtuara për të arritur rezultatet e pritura. Identifikimi i problemeve dhe më pas zhvillimi dhe zbatimi i suksesshëm i strategjive për të arritur zgjidhje. E familiarizuar me kushtet e vështira, reformat komplekse dhe proceset e ndryshimit, orientimin në rezultat, aftësinë për të kuptuar dhe shpjeguar problemet, për t'iu qasur atyre me fleksibilitet dhe durim. Me aftësi shumë të mira në menaxhimin dhe zbatimin e projekteve.

Me aftësi shumë të mira komunikimi për të ndërtuar marrëdhënie cilësore me palët e interesuara dhe menaxhmentin e lartë. Me aftësi shumë të mira menaxhuese dhe shumë të mira në delegimin efektiv. Drejtuese shumë e mirë e punës në grup. E aftë për motivimin e stafit vartës për t'u zhvilluar dhe për të kontribuar për të arritur objektivin dhe për të krijuar një mjedis të mirë që ata të rriten në karrierën e tyre. Identifikoj me kujdes dhe ofroj mundësinë e trajnimit për anëtarët e stafit të vartësisë.

Aftësi të larta të të menduarit në mënyre zhvilluese dhe aftësi të forta analitike.

Historiku i Punës

Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

17 Tetor 2022- Vijim

Menaxhoj dhe drejtoj punën lidhur me proceset e ekzekutimit të buxhetit nëpërmjet Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ), administrimin e mjeteve monetare, mbajtjen e llogarive të kontabilitetit dhe raportimin financiar të Qeverisjes së Përgjithshme në përputhje me legjislacionin përkatës. Ndjek, drejtoj dhe monitoroj gjithë procesin e bërjes efektiv dhe zbatimin e treguesve të buxhetit vjetor në të gjitha nivelet e qeverisjes së përgjithshme dhe pranë çdo dege të Thesarit (36 dege në të gjithë vendin). Drejtoj dhe monitoroj zbatimin e kërkesave të ligjit organik të buxhetit, ligjit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, rregullat e kontabilitetit si dhe të procedurave të sistemit të Thesarit për ekzekutimin e buxhetit. Udhëheq në tërësi punën për hartimin, përmirësimin dhe

implementimin e standardeve ndërkombëtare të aplikueshme për financat publike në njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Drejtoj dhe trajtoj problemet e manaxhimit të llogarisë së unifikuar të Thesarit “Depozitë e Qeverisë” në Bankën e Shqipërisë, të llogarive të fondeve speciale dhe të llogarive të veçanta të çelura me urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë. Menaxhoj zbatimin e aktiviteteve të Strategjisë së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe të Qeverisë në fushën e përmirësimit të menaxhimit të shpenzimeve dhe të ardhurave buxhetore, të raportimit financiar dhe procesin e përshtatjes së sistemit të Thesarit në përputhje me përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor në zhvillim. Përcaktoj objektivat kryesore të drejtorisë së përgjithshme, nevojat për burime njerëzore, planin e punës, afatet e realizimit të tyre dhe monitoroj punën e stafit të drejtorisë së përgjithshme dhe degëve të thesarit në rrethe për arritjen e objektivave.

Drejtor i Procesimit të Biznesit

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

03 Qershor 2010- 17 Tetor 2022

Kam menaxhuar dhe mbikqyrur punën nëpërmjet hartimit të procedurave teknike dhe funksionale, zbatimit, administrimit dhe mirëmbajtjes funksionale të Sistemit të Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ), me qëllim sigurimin e një sistemi modern për procesin e ekzekutimit të buxhetit dhe raportimin financiar bazuar në standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare.

Kam drejtuar procesin e mbështetjes funksionale për identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve në SIFQ, procesin e ndërveprimit për shkëmbimin e të dhënave të nevojshme sipas proceseve të punës ndërmjet SIFQ me bankat e nivelit të dytë, Bankën e Shqipërisë, Sistemin e Burimeve Njerëzore (HRMIS), Sistemin Informatik Tatimor, Sistemin Informatik të Prokurimit Publik etj.

Kam drejtuar punën për përgatitjen e termave të referencës për projekte të ndryshme lidhur me zhvillimin e SIFQ në bashkëpunim me strukturat e tjera të përfshira në projekte.

Bazuar në praktikën më të mira të vendeve të tjera propozimi i ideve novatore për nevojat të reja në legjislacionin e financave publike.

Përgjegjëse e Sektorit të Menaxhimit të Cash-it dhe Parashikimit Financiar

Drejtoria e Thesarit

Ministria e Financave

07/2009-06/2010

Gjatë kësaj periudhe fokusi i punës time ka qënë: Sigurimi i një administrimi financiar optimal të burimeve financiare të qeverisë nëpërmjet programit të monitorimit të fluksit hyrës dhe dalës të llogarive të qeverisë, bashkëpunimi me Departamentin e Borxhit, Drejtorinë Makroekonomike, Administratën Tatimore dhe Doganore dhe institucionet buxhetore për të siguruar në kohë likuiditetin dhe funksionimin normal të shërbimeve publike, hartimi dhe monitorimi i zbatimit të Marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Financave, Bankës së Shqipërisë dhe Bankave të Nivelit të Dytë, vendosja e procedurave të qarta për zbatimin e procesit të ekzekutimit të të ardhurave të arkëtueshme dhe shpenzimeve buxhetore ndërmjet sistemit të thesarit dhe sistemit bankar.

Specialiste e Sektorit të Menaxhimit të Cash-it dhe Parashikimit Financiar

Drejtoria e Thesarit

Ministria e Financave

02/2005-07/2009

Gjatë kësaj periudhe fokusi i punës time ka qënë: mbledhja dhe përpunimi i informacionit mbi planin e arkës nga të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe përshtatja e tij për përdorimin efektiv të likuiditeteve të qeverisë, ofrimi i mbështetjes ndaj njësive të qeverisjes së përgjithshme për një planifikim real të nevojave të tyre në para, përgatitja e raporteve bazuar në informacionin e marrë nga burime të ndryshme për një menaxhim më të mirë të parasë së gatshme dhe parashikimeve financiare, ekzekutimi korrekt i marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Financave, Bankës së Shqipërisë dhe Bankave të Nivelit të Dytë lidhur me mbledhjen e të ardhurave dhe procesin e ekzekutimit të pagesave buxhetore.

Specialiste e Sektorit të financimit të huaj dhe Borxhit

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit dhe Borxhit

Ministria e Financave

11/2003- 02-2005

Gjatë kësaj periudhe fokusi i punës time ka qënë: monitorimi dhe zbatimi i procedurave të administrimit të llogarive të veçanta bankare për projektet e financimit të huaj të mbajtur në Bankën e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë, përgatitja e raportit financiar mujor për disbursimet dhe shpenzimet për projektet e financimit të huaj.

Specialiste e Sektorit të Shpenzimeve

Dega e Thesarit të Tiranës

Ministria e Financave

09/1995- 05/1997 dhe 04/2001- 11/2003

Gjatë kësaj periudhe fokusi i punës time ka qënë: sigurimi i rregullsisë në kryerjen e shpenzimeve nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme në përputhje me procedurat ligjore të shpenzimeve buxhetore dhe rregullat e kontrollit të brendshëm financiar publik, mbështetja e njësive të qeverisjes së përgjithshme për një kuptim më të mirë dhe zbatim efektiv të udhëzimeve dhe standardeve të kontabilitetit në fuqi në procesin e ekzekutimit të buxhetit, raportimi financiar i shpenzimeve buxhetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme.

Fusha të Tjera të Rëndësishme

Autor i kurrikulës dhe Lektor për Programin e Certifikimit të Auditimit të Brendshëm
organizuar nga Ministria e Financave

2014-2015

Tematika e trajtuar mbi kontrollet e sistemit të informacionit: cilat janë sistemet e informacionit dhe llojet e tyre, qasja standarde ndaj auditimit të sistemeve të informacionit, programi i auditimit të sistemeve të informacionit, politikat dhe standardet për sigurinë e sistemeve të informacionit.

Trajner Funkcional i Sistemit të Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ) 2007 – në vazhdim
Trajnim i stafit të degëve të thesareve në rrethe, drejtorive në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme me qasje të drejtpërdrejtë në SIFQ për ekzekutimin e buxhetit të tyre dhe raportimin financiar (20 NJQP: të gjitha Ministrinë e Linjës, 3 Bashki dhe 5 institucione të varësisë).

Trajner i Standarteve Nderkombetare te Kontabilitetit Publik me baza te konstatuara (IPSAS Accrual) *2022- në vazhdim*

Trajnim i stafit të punonjësve të financës të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme të përzgjedhur për trajnim lidhur me standartet ndërkombëtare të kontabilitetit publik mbi baza rritëse në të gjithë Shqipërinë.

Anëtare dhe përfaqësuese e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë së Shqipërisë në programet ndërkombëtare të Bankës Botërore (prej vitit 2010 e në vazhdim): PEMPAL për Komunitetin e Thesarit dhe **PULSAR** për Kontabilitetin në Sektorin Publik dhe Raportimin Financiar, si dhe referuese në workshopet e organizuara nga këto dy programe dhe të tjera në shtete të ndryshme jashtë Shqipërisë (Austri, Kore e Jugut, Bullgari, Hungari, Slloveni, Suedi, Kroaci, Qipro, Rusi, Kazakistan, Gjeorgji, Estoni, Letoni, Turqi, Azerbaixhan etj.), mbi tematika të lidhura me funksionet e thesarit, me proceset e ekzekutimit të buxhetit, kontrollit të brendshëm financiar, konsolidimit dhe raportimit financiar, menaxhimin e riskut, menaxhimin e likuiditeteve të qeverisë dhe parashikimin financiar, strategjitë për modernizimin e sistemit të thesarit nëpërmjet automatizimit të proceseve të punës dhe integritit të sistemeve të informacionit etj.